



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2018:043757

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05617506

P.nr.181/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Dega Istog, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve R.A, V.H, S.H dhe L.A për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1192/18 të datës 07.08.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor publik me datë **25.04.2024**, në prani të Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi, të dëmtuarve I. Ldhe V.R, të pandehurve V.H, S.H, L.A dhe mbrojtësit të pandehurit R.A, av. Fadil Jashari, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- 1. R.A**, nga i ati A. dhe e ëma N., e gjinisë M., i lindur me datë ... në Istog, me vendbanim në fshatin I. Komuna I., gjithashtu me vendbanim të përhershëm në shtetin e Z. në qytetin L. V. S. nr.10, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. V.H**, nga i ati H. dhe e ëma R., e gjinisë M., i lindur me datë ... në Istog, me vendbanim në fshatin U. Komuna I., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 3. S.H**, nga i ati H. dhe e ëma R., e gjinisë M., i lindur me datë ... në fshatin U., ku edhe banon, Komuna I., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4. **L.A** nga i ati **E.** dhe e ëma **K.** e gjinisë **S.**, i lindur me datë ... në **I.**, me vendbanim në fshatin **I** i **P.** Komuna **I.**, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. gjendet në liri.

Konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së:

LIROHEN NGA AKUZA

Sepse:

Me datë 30.06.2018, rreth orës 19:00, në Istog, pikërisht në oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja”, në bashkëkryerje dhe me forcë tentojnë që t’i pengojnë zyrtarët policor në kryerjen e detyrave zyrtare dhe atë zyrtarët **J.B, I.Sh, Sh.A, B.K, D.B, V.R, K.A, I.L, A.M** dhe **A.G**, në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor kishin marrë informacion se në bjeshkët e Istogut janë prerë drunjtë në mënyrë të kundërligjshme dhe të njëjtit dalin në vendin e ngjarjes, pasi që hasen në të pandehurit të cilët ishin me mjete transportuese për drunjtë e prerë, nga këta të fundit kërkojnë që t’i shoqërojnë deri tek kompania e mirëmbajtjes së drunjtëve në Istog, dhe me të arritur në oborrin e kompanisë se mirëmbajtës, të pandehurit të revoltuar shkojnë drejtë zyrtarëve policorë duke tentuar që t’i godasin me grushta dhe shqelma, mirëpo në ato çaste zyrtarët policorë përdorin sprej lotsjellës dhe i arrestojnë të pandehurit.

- me çka kishin për të kryer veprën penale **pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**
- Sepse, nuk është provuar se te akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Shpenzimet e kësaj procedure penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Palët e dëmtuara: **D.B** nga fshati **S.** rr. “Lugu i Drinit” Komuna **I.**, **V.R**, me vendbanim në rr. “**M.M**” Komuna **P.**, **K. A.**, nga fshati **Sh.** e **Ulët** Komuna **I.**, **I.L** me vendbanim në rr.”**S.L**” Komuna **P.**, **A.M** me vendbanim në rr. “**Zh.V**”, nr.12 Komuna **P.**, **Sh.A**, me vendbanim në fshatin **Sh.** rr. “**R.A**”, Komuna **I.** dhe **A. G.** me vendbanim në rr. “**K.**” Komuna **I.**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritë aktakuzën **PP.II.nr.1192/2018** të datës **07.08.2018** ndaj të akuzuarve **R.A, V.H, S,J, S.H** dhe **L.A** për shkak

të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.09.2023, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit Ardiana Veseli, mbrojtësi i të akuzuarit R.A, av. Fadil Jashari dhe të pandehurit V.H, R.A, S.H dhe L.A Gjykata për shkak të mos prezencës së të akuzuarit Sokol Januzaj, i cili nuk ka prezantuar në këtë seancë të shqyrtimit fillestar dhe as në seancat tjera të mëhershme edhe pse ndaj të njëjtit ka qenë e urdhëruar sjellja me shoqërim, pas propozimit të prokurorit të shtetit se ndaj të njëjtit të veçohet procedura penale për shkak të efikasitetit të procedurës, janë marrë mendimet e palëve prezent lidhur me veçimin e kësaj procedure penale në raport me të akuzuarin Sokol Januzaj, ku pasi janë dëgjuar palët prezentë dhe pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lënës në pajtim me nenin 35 të KPP-së, gjykata ka marrë aktvendim, me të cilin e ka urdhëruar veçimin e procedurës penale në raport me të akuzuarin Sokol Januzaj dhe ndaj të njëjtit të lëshohet urdhërarrest, e cila lëndë e veçuar ndaj tij do të evidentohet me numër të ri të lëndës.

Ndërsa sa i përket të akuzuarve tjerë prezent në seancë, R.A, V.H, S.H dhe L.A është vendosur që procedura do të vazhdohet me numrin ekzistues të lëndës. Pastaj, pasi që prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën, dhe gjykata pasi që është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të akuzuarve R.A, V.H, S.H dhe L.A të deklarohen për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehurit, R.A, V.H, S.H dhe L.A kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Pastaj gjykata të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre i ka udhëzuar për të drejtat ligjore nga neni 243 dhe 244 të KPP-së për parashtrimin e kërkesës për kundërshtim të provave dhe hudoje të aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.A, av. Fadil Jashari me datë 09.10.2023 ka parashtruar kërkesë për kundërshtimin e provave dhe hudojen e aktakuzës.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesat për kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudoje të aktakuzës, me aktvendimin e datës 23.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara, i cili aktvendim është vërtetuar sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.62/24 të datës 26.01.2024.

Gjykata pastaj ka urdhëruar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datë 19.04.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi, të dëmtuarit J.B, I.Sh, D.B, K.A, A.M, B.K dhe A.G të pandehurit R.A se bashku me mbrojtësin e tij av. Fadil Jashari, V.H, S.H dhe L.A, në të cilën seancë është dhënë fjala hyrëse nga palët, dhe janë dëgjuar të dëmtuarit: B.K, J.B, I.Sh, D.B K.A, A.M dhe A.G gjithashtu gjatë kësaj seancë i pandehuri R.A, ka kërkuar dhe ka dhënë pëlqim se në këtë çështje të gjykohe në mungesë për shkak të problemeve shëndetësore dhe tretmanit mjekësor të cilin është duke e marrë në shtetin e Zvicrës.

Me datë 25.04.2024 është vazhduar mbajtja e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë fillimisht mbrojtësi i të pandehurit R.A, av. Fadil Jashari ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i tij për arsye shëndetësore nuk prezanton ne seancë dhe meqenëse i njëjti ne seancën e kaluar ka propozuar dhe ka dhënë pëlqim qe të gjykohet në mungesë, ka propozuar që i njëjti të gjykohet në mungesë ngase edhe i mbrojturi i tij është i pajtimit që të gjykohet në mungesë. Pas kësaj gjykata të njëjtën ditë ka mbajtur seancën dëgjimore, ku pas dëgjimit të palëve ka vendosur që konform nenit 303 te KPP-së, gjykimi ndaj te pandehurit R.A, në këtë çështje penale te vazhdohet ne mungese. Për faktin se i akuzuari R.A, ka prezantuar në seancën fillestare dhe seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, e ka gjendjen jo të mirë shëndetësore për të cilën arsye personalisht dhe përmes mbrojtësit te tij ka deklaruar se është i pajtimit të gjykohet në mungesë, dhe meqenëse gjykata ka vështirësi për shtyrjen e gjykimit deri në përmirësimin gjendjes shëndetësore te pandehurit, për shkak edhe te afateve ligjor te ndjekjes penale. Pastaj seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar të njëjtën ditë, në të cilën seancë është dëgjuar i dëmtuari V.R dhe i dëmtuari Isa Lajçi, është bërë administrimi i provave materiale, është dhënë mbrojtja e të akuzuarve dhe fjala përfundimtare nga palët.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar: ne këtë shqyrtim gjyqësor kemi dëgjuar dëshminë e dëshmitarëve – te të dëmtuarve ku nga dëshmia e tyre te dhëna pranë kësaj gjykate është vërtetuar se me 30.06.2018 pikërisht tek oborri i kompanisë “Mirëmbajtja “ te pandehurit nuk i kishin zbatuar urdhrin sipas policisë dhe te njëjtit i kanë penguar si grup ne kryerjen e detyrave te tyre , fillimisht te pandehurit sipas dëshmimeve te dëshmitarëve te pandehurit kishin refuzuar te vinin ne stacionin policor dhe pasi qe te njëjtit kishin refuzuar kishin filluar të shkojnë ne drejtim te zyrtareve policor duke gjuajtur me dorë, duke ngritur zë te larte, duke thënë se ndaj juve duhet te ishte përdorur kallashi, duke ju thënë se xhandarmeria ish marr vesh me juve, ku njeri zyrtar policor ishte dashur te përdor edhe sprejin. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit te dëmtuarit K.A është vërtetuar se gjersa kishte qene duke arrestuar njeri nga te pandehurit, kishte vërejtur se te gjithë te pandehurit kishin mësyre ne drejtim te tyre, kishin mësyre ne drejtim te zyrtareve policor duke i penguar qe te kryejnë detyrën zyrtar e ku aty kishte qene duke kryer arrestime polici I.L dhe D.B, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit A.M i cili ka qene prezent pikërisht ne vendin e ngjarjes, është vërtetuar se pasi qe te pandehurit kishin filluar te festojnë ikjen e një traktori , ku aty kishin filluar edhe kërcënimet drejt zyrtareve policor dhe pas kërcënimeve kishin filluar te shkojnë ne drejtim te zyrtareve policor me qellim qe ti pengojnë ne kryerjen e detyrës zyrtar, po ashtu nga dëshmia dëshmitarit A. at dite kishte qenë te dëmtuarit I.L, ku si grup te gjithë kishin shkuar ne drejtim te tyre dhe njeri nga ata e kishte kapur për uniforme, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit është vërtetuar se qëllimi kryesor ku te pandehurit kishin shkuar ne drejtim te zyrtareve policor ka qene me qellim qe ti pengojnë na arrestimin e tyre. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit A.G është vërtetuar se me dt. 30.06.2018 derisa ishin duke kryer detyrën zyrtare ne vendin kritik , te pandehurit se bashku kanë penguar kolegun I.L ku është dashur te përdor edhe sprej. Nga dëshmia e dëshmitarit V.R ne këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se ditën kritike nga te pandehurit V. S., S. dhe L. është penguar ne kryerjen e detyrës zyrtar e, po ashtu është vërtetuar se përdorimi i sprejt ka qene me qellim qe t'a largoj turmën e cila ishte duke shkuar ne drejtim te zyrtareve policor, ndërsa sjellje me te thekuar sipas

dëshmisë se dëshmitarit të dëmtuarit kishte pasur V.H karshi zyrtareve policor. Nga dëshmia e dëshmitarit I.L u vërtetua se ditën kritike në vendin e ngjarjes pasi që kishte shkuar për të asistuar koleget e tij kishte asistuar nga se të pandehurit kishin pasur sjellje kërcënuese, dhe kishin penguar zyrtaret policor në kryerjen e detyrave zyrtare dhe me të arritur në vendin e ngjarjes i pandehuri S.J i pari ishte ofruar në drejtim të tij që ta sulmoj mirëpo i njëjti kishte përdorur sprej që ta zmbrops, ndërsa i pyetur nga prokurori se cilat ishin veprimet e të pandehurve të tjerë, i njëjti ka deklaruar se nuk ka mundur që t'i vërej sepse ka pasur pengesa në shikim për shkak të sprejve të përdorur. Po ashtu edhe nga administrimi i provave materiale në tërësi është vërtetuar se ditën kritike në vendin kritik të pandehurit duke vepruar si bashkë kryes me force dhe kanosje pengojnë zyrtaret policor në kryerjen e detyrave zyrtare dhe atë të dëmtuarit D.B, V.R, K.A, I.L, A.M, A.G në atë mënyrë që derisa zyrtaret policor kishin marr një informacion se në bjeshkët e Istogut janë prerë drunjtë, në mënyrë të kundërligjshme, siç ceket edhe me tutje në përshkrimin faktik të kësaj aktakuze. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat qëndrojnë në tërësi pranë kualifikimit juridik të veprës penale dhe propozoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit si rrethanë rënduese të merret parasysh dashja e lartë, mënyra e kryerjes së veprës penale, po ashtu të merret parasysh sjellja e të akuzuarve V.H dhe S.H ku të njëjtit gjatë seancave gjyqësore kanë pasur prapë kërcënime dhe fjalë fyese në drejtim të dëmtuarave.

I dëmtuari V.R, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pajtohet me deklaratimet e prokurorit të shtetit dhe se ndihet i dëmtuar në këtë rast.

I dëmtuari I.L në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pajtohet me deklaratimet e prokurorit të shtetit dhe se ndihet i dëmtuar në këtë rast

Mbrojtësi i të pandehurit R.A av. Fadil Jashari në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar edhe në seancë, ka deklaruar se: sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, me numër PP.II.1192/18 të datës 07.08.2018, ndaj të pandehurve V.H, Sokol Januzaj, S.H, L.A dhe të mbrojturit tim z. R.A për shkak të veprës penale në bashkëkryerje pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Mbrojtja në këtë rast pretendimet e prokurorisë i kundërshton në tërësi dhe se kjo është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor P.nr.181/18, në Gjykatën Themelore në Pejë Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm-divizioni Penal i datës 19 prill 2024. Në fjalën hyrëse të mbajtur në seancën e shqyrtimit gjyqësor në çështjen penale me datë 19 prill 2024, për të mbrojturin tim z. R.A mbrojtja vlerëson se nuk mund të qëndroj cilësimi juridik i veprës penale ashtu siç është përshkruar në aktakuzë, sepse sipas provave që gjinden në dosje të lëndës, edhe përshkrimi të dispozitivit të aktakuzës vërehet se i mbrojturi im R.A, nuk ka pasur dijeni apo njohuri sipas pretendimeve të prokurorisë për pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në vendin e njohur tani për gjykatën, deri kur janë arrestuar nga Policia e Kosovës të cilin veprim i mbrojturi im nuk ka rezistuar në asnjë moment dhe rrethanë, siç përshkruhet në dispozitën e nenit 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase në asnjë mënyrë i mbrojturi im nuk ka qenë në dijeni për veprimet e ndërmarra në ditën kritike. Se nuk qëndron konstatimi i tillë si në dispozitivin e aktakuzës të përshkruar nga Prokuroria, mbrojtja e dëshmon edhe me faktin tjetër duke konstatuar edhe nga procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i mbajtur me datë 19.04.2024, dhe janë dëgjuar fillimisht të dëmtuarit, administruar edhe prova tjera

materiale, ku në të gjitha raportet shihet qartë se i mbrojturi im z. R.A nuk është i përfshirë në pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare sipas pretendimeve të Prokurorisë së Shtetit. Gjatë marrjes në pyetje nga Prokurori i Shtetit i dëmtuari J.B deklarohet se nuk ishte prezent kur dyshohet se i mbrojturi im R.A dhe të tjerët kanë sulmuar zyrtarët policor, dhe deklarohet se nuk ndihet i dëmtuar në këtë rast. Po ashtu edhe zyrtari policor I.Sh i dëmtuar sipas prokurorisë së shtetit në deklaratën e tij thekson se nuk ishte prezent dhe nuk ndihet i dëmtuar nga veprimi i të mbrojturit tim R.A në ditën kritike. Një ashtu i dëmtuari B.K deklarohet se raporti i tij nuk evitohet në aktakuzë dhe deklarohet se kam qenë prezent në oborrin e kompanisë “mirëmbajtja” në ditën kritike dhe nuk ndihem i dëmtuar nga të pandehurit e në këtë rast as nga i mbrojturi im R.A. Oficerët policor K.A, A.G, D.B dhe A.M, qëndrojnë pranë raportit të dhënë në lidhje me këtë rast të cilat më vonë do t’i elaborojmë lidhur me pretendimet e tyre në raport me të mbrojturin tim. I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit B.K, në shqyrtimin kryesor të datës 19.04.2024 deklarohet se ishte polici i parë i cili kishte intervenuar në lidhje me këtë rast dhe se gjatë intervenimit nuk ishte sulmuar apo penguar nga tani të akuzuarit sipas aktakuzës së prokurorisë. Dëshmitari J.B deklarohet se me datën 30.06.2018, kam intervenuar në bjeshkët e Istogut, sepse kishim informata se disa persona po prisnin drunjtë në këto bjeshkë mirëpo nuk isha prezent në oborrin e kompanisë mirëmbajtja dhe nuk e di çfarë ka ndodhur aty. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.04.2024, oficeri policor I.SH në cilësinë e të dëmtuarit sipas pretendimeve të prokurorisë, deklarohet se në ditën kritike nuk ishte prezent në oborrin e kompanisë, mirëmbajtja dhe se intervenimi i tij ishte vetëm në bjeshkë. Kështu edhe në rast del se i mbrojturi im R.A nuk i kishte sulmuar apo penguar oficerët policor në kryerjen e detyrës zyrtare. Zyrtari Policor z. D.B në deklaratën e tij të dhënë me datë 19.04.2024, në shqyrtimin kryesor pranë Gjykatës Themelore në Pejë dega në Istog, thuhet se janë penguar nga të pandehurit në këtë rast, edhe nga i mbrojturi im R.A, pa e specifikuar apo ofruar fakte shtesë të bazuara në prova apo argument tjetër përveç se duke e shpjeguar verbalisht dhe pa asnjë dëshmi shtesë me të cilën kish me arrit me argumentuar para gjykatës dhe të pranishmëve në sallë, se në këtë ditë i mbrojturi im ka penguar ose sulmuar oficerët policor në kryerjen e detyrës zyrtare. Sipas deklaratës në këtë datë 19.04.2024, thuhet nga i dëmtuari se në kohën kur na kanë sulmuar ishte errësirë dhe nuk janë vërejtur personat në fytyrë, por ju kujtojë juve si gjykatë se në ora 19:00 të datës 30.06.2018, konsiderohet si ditë e zgjatur dhe ka mjaftë dritë natyrale sa për të ditur ose identifikuar se cili nga të pandehurit e ka penguar apo sulmuar personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare apo me konkretisht nga i mbrojturi im z. R.A, dhe konsideroj se nuk është arritur të sqarohet qartë edhe me fakte se veprimet e të akuzuarve ka penguar zyrtarët policor në ditën kritike. Oficeri policor K.A në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.04.2024, deklarohet se në ditën kritike nuk është penguar nga të pandehurit në kryerjen e detyrës zyrtare, dhe cila është arsyeja që i mbrojturi im në këtë rast të akuzohet sipas pretendimeve të prokurorisë në pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare. Përkundër kësaj cilin fakt ose argument duhet ne si mbrojtje të ofrojmë që një veprim të tillë z. R.A nuk e ka ndërmarrë, derisa vet të dëmtuarit me deklaratat e tyre e dëshmojnë të njëjtën. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës së njëjtë i dëmtuari A.M deklarohet se ka qenë prezent në ditën kritike dhe ka qenë errësirë kur kanë filluar të pandehurit të festojnë se një traktor ishte shmangur, duke na ofenduar neve me fjalë fyese etj., ku pastaj është acaruar situata dhe janë ofruar për të na sulmuar, një pretendim i tillë nuk qëndron sepse më datë 30.06.2018, në ora 19:00, për të cilën po pretendohet se ka ndodhur një veprim nga i mbrojturi im R.A, ka qenë ditë dhe është mjaftë e

ndriqeshme sa për tu vërejtur se cili nga të akuzuarit i ka sulmuar apo penguar policinë në kryerjen e detyrës zyrtare. Njëherë është deklaruar se nuk me kujtohet se i mbrojturi im z. R.A ta këtë penguar në kryerjen e detyrës zyrtare. Ku në këtë rast nuk është i përfshirë dhe as nuk i ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare z. R.A sipas pretendimeve të Prokurorisë. Pas përfundimit të këtij shqyrtimi gjyqësor me rastin e analizimit të të gjitha provave të administruara kam ardhur në përfundim që gjendja faktike e cila ka qenë e paraqitur në aktakuzë nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë lidhur me pretendimet e Prokurorisë se i mbrojturi im z. R.A ka kryer veprën penale për të cilën po akuzohet. Andaj duke marrë parasysh shkresat e lëndës provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në çështjen penale i datës 19 dhe 25 prill 2024, gjyqtari i vetëm gjykues i kësaj çështje të bie vendim meritore për të mbrojturin tim z. R.A. Duke u mbështetur në të gjitha provat që gjenden në dosje të lëndës dhe faktet që u administruan në çështjen penale PP.II.nr.1192/18 të datës 19 dhe 25 prill 2024, kërkojmë nga gjykata për të mbrojturin tim R.A ta shpallë të pafajshëm dhe të sjellë aktgjykim lirues për të.

I akuzuari V.H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se nuk e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale dhe me asnjë veprim ditën kritike nuk e kam penguar asnjë zyrtar policor.

I akuzuari S.H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se nuk e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale dhe me asnjë veprim ditën kritike nuk e kam penguar asnjë zyrtar policor.

I akuzuari L.A në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se nuk e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale dhe me asnjë veprim ditën kritike nuk e kam penguar asnjë zyrtar policor.

Gjykata në bazë të nenit 7 të KPP-së, në shqyrtimin gjyqësor saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm në këtë çështje penale, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë, vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes së tij. Me ndërgjegje dhe në bazë të ligjit u vlerësua çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, u vërtetua kjo gjendje faktike nga provat e administruara si me poshtë.

Provat e administruara:

Pasi që të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar sipas aktakuzës, gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë nga:

Provat personale:

- Dëgjimi i të dëmtuarit B.K, zyrtar policor pranë stacionit policor në Jasonevik.
- Dëgjimi i të dëmtuarit J.B, zyrtar policor pranë stacionit policor në Istog.
- Dëgjimi i të dëmtuarit I.Sh, zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë.

- Dëgjimi i të dëmtuarit D.B zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë
- Dëgjimi i të dëmtuarit K.A zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë.
- Dëgjimi i të dëmtuarit A.M, zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë.
- Dëgjimi i të dëmtuarit A.G , zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë.
- Dëgjimi i të dëmtuarit V.R, zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë.
- Dëgjimi i të dëmtuarit I.L, zyrtar policor pranë stacionit policor në Pejë.

Provat materiale:

- Leximi i procesverbalit mbi intervistimin e të dyshuarit L.A i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018.
- Leximi i procesverbalit mbi intervistimin e të dyshuarit R.A, i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018..
- Leximi i procesverbalit mbi intervistimin e të dyshuarit S.H, i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018.
- Leximi i procesverbalit mbi intervistimin e të dyshuarit V.H, i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018.
- Leximi i raportit të shpejtë i datës 30.06.2018.
- Leximi i procesverbalit mbi intervistimin e të dyshuarit F.S, i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 30.06.2018.
- Leximi i raporteve të oficerëve J.B, D.B, A.G A.M, I.L V.R, K.A dhe G.A.
- Shikimi i fotoalbumit të bashkangjitur në kallëzimin penal.

Provat personale

Dëshmitari B.K ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: me datë 30.06.2018 me sa me kujtohet kam qene në punë ne ndërrimin e para ditës, dhe sa i përket e këtij rasti për te cilin akuzohen, unë kam qene polici i parë qe kam intervenuar, përkatësisht ne bjeshkët e Radushës apo Moknes. Gjithashtu te oborri i kompanisë “Mirëmbaja” kam intervenuar, ndërsa sa i përket këtu *te pandehurve unë te njëjti nuk i njoh, ndërsa gjatë intervenimit ne oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja” nuk jam sulmuar apo penguar ne ndonjë formë nga te njëjtit*, ndërsa unë ne këtë rast vetëm kam asistuar sepse ashtu me është kërkuar nga eproret e mi. Përkatësisht unë personalisht nuk jam penguar ditën kritike nga askush.

Dëshmitari J.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: me kujtohet se lidhur me këtë rast konkret kam marr pjesë ne bjeshkën e Istogut për te intervenuar, ku kanë qene këtu te pandehurit duke prerë drunjtë, ndërsa *unë nuk kam njohuri se çfarë ka ndodhur ne oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja “ sepse unë aty nuk kam intervenuar dhe as nuk kam qene prezent*. Ne këtë rast nuk jam penguar ne asnjë mënyrë nga te pandehurit dhe as nuk e ndjej vetin te dëmtuar.

Dëshmitari I.Sh në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: sa i përket datës 30.06.2018 unë nuk kam qene ne oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja”, mirëpo unë ne këtë rast kam intervenuar vetëm ne bjeshkë. *Gjatë intervenimit nuk jam penguar ne asnjë formë nga te pandehurit dhe nuk e ndjej vetin te dëmtuar ne këtë rast.*

I dëmtuari I.Sh, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: sa i përketë këtij rasti qëndroj pranë raportit të dhënë, gjithashtu unë atë dite kam intervenuar në oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja “ ku kanë qene këtu të pandehurit, ku atë dite gjatë intervenimit ka pasur moszbatim të urdhrave nga të pandehurit dhe pengim të cilët na kanë penguar në kryerjen e detyrave tona. Pastaj kur kemi mrrë në oborrin e kësaj kompanie kemi vërejtur se një traktor nuk ka ardhur nga bjeshka sipas kërkesës sonë, pastaj këtu të pandehurit janë gëzuar këtij fakti dhe kur nga të njëjtit kemi kërkuar që të vijnë në stacion policor për të dhënë deklaratë të njëjtit kanë refuzuar. Pasi të njëjtit kanë refuzuar të vijnë në stacion Policor, kanë filluar që të vijnë si grup në drejtim tonin duke gjuajtur edhe me duar, *nuk me kujtohet se cili konkretisht ka bërë ato veprime sepse ka qene terr, ndërsa mua personalisht nuk ma kujtohet se ndonjëri nga të pandehurit ka tentuar të më godet , apo pengoj sepse me sa me kujtohet këta kanë vepruar vetëm si grup siç deklarova edhe më lartë, unë personalisht ndaj këtu të pandehurve nuk kam përdorur asnjë armë dhe kam pasur me veti, nga lëvizjet dhe ecja jo normale të pandehurve neve na është bërë e qartë që duhet të veprimë dhe me ç’rast nga disa polic aty është përdorur dhe sprej, gjithashtu të pandehurit kanë pasur edhe ton të lartë të zërit, duke thënë se ndaj jush është dashur të përdoret kallashnikovi, ku kishin ardhur gjandarmeria dhe ishin marrur me juve. Siç deklarova më lartë *nuk me kujtohet se kush çfarë veprimeve kanë ndërmarr, por me kujtohet se të njëjtit kanë vepruar si grup. Sa i përketë të pandehurit V.H, me sa më kujtohet unë e kam arrestuar, ndërsa nuk kam përdorur forcë e cila është në kundërshtim me rregullat e policisë, përveç forcës së nevojshme për ta vënë në kontroll një person gjatë arrestimit.**

I dëmtuari K.A në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: sa i përket ditës kritike me datë 30.06.2018 kam qene prezent gjithashtu edhe në oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja”, ndërsa kur këtu të pandehurit kanë filluar të reagojnë pasi në kemi filluar të arrestojmë, *mua nuk me ka penguar ndonjëri i pandehur që të kryej ndonjë veprim , mirëpo unë kam asistuar kur koleget e mi kanë tentuar që të arrestojnë njërin nga të pandehurit dhe kam ndaluar persona tjerë që të ofrohen dhe mos të pengojnë arrestimin e atij personi, me sa me kujtohet të pandehurit kanë përdorur edhe fjalë fyese ndaj nesh, duke përmendur edhe përdorimin e armëve, unë nuk kam përdorur asnjë armë kritike, unë personalisht nuk kam qene i penguar që të ndërmarr ndonjë veprim nga asnjëri i pandehur. Me sa me kujtohet ditën kritike sprej ka përdorur Polici Isa Lajqi dhe i njëjti ka qene sipas meje cak i sulmit nga këtu të pandehurit, gjithashtu i penguar ka qene edhe polici Daut Berisha i cili ka qene përgjegjës i patrullës, me sa me kujtohet pasi që është përdorur sprej të gjithë të akuzuarit kanë reaguar. Në oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja” me sa me kujtohet ka qene mbrëmje, ka qene terr dhe s’ka pasur ndriçim nuk me kujtohet saktë. *Sa i përketë të pandehurit R.A e kam parë aty kur e kanë prangosur, dhe me sa me kujtohet ky është prangosur i fundit dhe i njëjti nuk me ka penguar mua personalisht në asnjë formë. Sa i përketë të pandehurit V.H nuk me ka penguar në asnjë formë.**

I dëmtuari A.M në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: me datë 30.06.2018 unë kam qene prezent në oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja”, atë ditë ka qene terr dhe errësirë, këtu të pandehurit kanë filluar që të festojnë që një traktor ishte shmangur , fillimisht kanë filluar me fjalë kërcënuese në drejtim tonin dhe sharje, pastaj kanë filluar që të vijnë në drejtimin tonë si grup pesë persona me qellim që të na pengojnë, pasi që ju kemi thënë se duhet të shkojmë në stacion policor me dhënë deklaratë për këtë rast. Unë kam qene afër kolegut I.L dhe këta si grup

janë ofruar afër neve dhe njëri nga këta ka filluar që te na kap për uniforme, dhe te na ofrohen afër nesh duke na thënë se duam te ua njohim fytyrat se do te kemi pune me juve, ndërsa *mua me kujtohet se dikush me ka kapur për uniforme, por nuk mund te di saktë se cili nga këtu te pandehurit me ka kapur*, mirëpo mendoj se reagimet e te pandehurve kanë që ne me qellim që te na sulmojnë dhe pengojnë, pastaj kolegu I.L e ka përdorur sprejin ne drejtim te pandehurve. Ndërsa pastaj kemi filluar që ti arrestojmë, te njëjtit kanë përdorur force. Mirëpo edhe neve është dashur që te përdorim forcë duar thatë, për ti vënë nen kontroll dhe *gjatë arrestimit te një personi, mua dikush me ka tërhequr mbrapa duke me kapur, mirëpo nuk ma kujtohet se kush ka qene ai. Unë kam qenë i penguar nga te gjithë te pandehurit, mirëpo nuk mund te veçoj se cili më ka kapur për uniforme*. Sa i përket të pandehurit R.A, nuk me kujtohet se a e kam arrestuar të njëjtin, dhe nuk me kujtohet nëse Rexha me ka penguar, mirëpo sa me kujtohet siç deklarova me lartë të gjithë se bashku na kanë penguar në kryerjen e detyrave.

I dëmtuari A.G në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: me datë 30.06.2018 kur ka ndodhur rasti kritik, unë kam qenë prezent në oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja”, gjatë asaj kohe këtu te pandehurit kanë përdorur fjalë fyese ne drejtim tonin, ndërsa *mua personalisht nuk me ka penguar ndonjëri prej tyre, ka qene terr dhe nuk me kujtohet se cili nga zyrtaret policor, te pandehurit e kanë penguar*, por mendoj se ndonjërin prej tyre e kanë penguar. *Dhe nuk me kujtohet se cili nga këtu te pandehurit e ka shtyrë me duar ndonjërin nga zyrtaret policor te cilët kanë qene prezent*, mirëpo me sa me kujtohet te gjithë te pandehurit se bashku na kanë penguar, me sa me kujtohet kolegu I.L ka përdorur sprej ndaj te pandehurve, për shkak se te njëjtit kanë filluar te shfaqin shenja agresiviteti dhe kanë refuzuar që e te vijnë ne stacion policor.

I dëmtuari V.R në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: ditën kritike me datë 30.06.2018 kam qenë në detyrë si zakonisht ne vendin tim te punës ne Pejë, po ashtu për një problem na kanë thirrur nga stacioni policor ne Istog për te intervenuar ne bjeshkët e Istogut, për shkak se disa persona i kanë zënë me dru dhe janë sulmuar policet e stacionit policor ne Istog. Pastaj, ne oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja “ kemi vërejtur se mungon një traktor pastaj ju kemi thënë këtu te pandehurve që te thërrasin le te vij, pastaj te njëjti nuk kanë vepruar ashtu , kanë filluar që te festojnë , pastaj kanë filluar te reagojnë ne mënyrë demonstrative, te kërcënojnë, dhe pastaj janë nisur drejt nesh *përveç te pandehurit R.A*, pastaj kolegu I.L ka gjuajtur sprej ne drejtim te tyre për ti zbrapsur, ndërsa konsideroj se te pandehurit kanë mësyre në drejtim tonin për qëllime kërcënuese duke na thënë duam te i’a shohim fytyrat dhe do te kemi pune me juve, si dhe konsideroj se pengesa nga te pandehurit është bere duke rezistuar që mos te arrestohen, ndërsa *unë te pandehurin R. e kam arrestuar, mirëpo i njëjti nuk ka rezistuar*. Nga veprimet e te pandehurve tjerë ndihem i penguar ditën kritike, ndërsa i dëmtuar nuk ndihem dhe konsideroj se qëllimi i kolegut tim për te gjuajtur sprej nga te pandehurit ka qene që te pandehurit mos te na ofrohen dhe te na sulmojnë ne ndonjë formë, qëllimi se pse na është dhënë urdhër për te i arrestuar ka qene për shkak se te njëjtit janë zënë duke prerë dru ne mënyrë ilegale dhe për ti dërguar ne stacion policor për te dhënë deklaratë. Personi i cili është dashur te arrestohet këtë dite ka qene pikërisht V.H, sepse i njëjti e ka kanosur Togerin Q.J, ndërsa ne policet nuk kemi pasur problem ndërmjet veti.

I dëmtuari I.L në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: ditën kritike me datë 30.06.2018 fillimisht kam qenë ne patrullë ne Pejë, pastaj nga Policia e Istogu jemi njoftuar për një problem ne bjeshkët e Istogut , dhe atje ne bjeshkë kur kemi shkuar jemi takuar me policet e stacionit policor në Istog dhe te dyshimitit, ndërsa kur kemi shkuar ne oborrin e kompanisë “Mirëmbajtja “ kemi vërejtur se mungon një traktor, kur i kemi pyetur te pandehurit te njëjtit kanë filluar qe te qeshin dhe te na ngacmojnë me fjalë, pastaj *mua personalisht personi S.J, te cilin emrin ja kam mësuar ne stacion policor, i njëjti i pari ka filluar qe te na ngacmoj dhe kanos, dhe ka filluar qe te afrohet afër meje duke tentuar qe te na godet*, unë pastaj jam tërhequr prapa dhe kam përdorur sprejin ndaj tij, pastaj e kemi arrestuar te njëjtin. *Ndërsa te pandehurit këtu prezent ne seancë nuk me kujtohet se me kanë penguar ne ndonjë formë sepse unë jam marrë vetëm me te pandehurin S.J duke e arrestuar*, gjithashtu nuk kam mundur me vërejtur se te pandehurit tjerë a i kanë penguar policet tjerë apo jo. Unë shtoj se pasi qe e kam përdorur sprejin edhe mua një pjese e sprejit me ka ra ne sy dhe ma ka vështirësuar te pamurit dhe nuk kam mundur te vërej veprime te pandehurve tjerë eventuale ne qofte se te njëjtat kanë qene te kundërligjshme. Edhe njëherë konfirmoj se sprejin e kam përdorur vetëm ndaj personit S.J i cili ka ardhur ne drejtim timin ku kam konsideruar se dëshiron te me sulmoj.

Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari V.H në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar: se nuk e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale dhe do të mbrohet në heshtje.

I akuzuari S.H në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar: se nuk e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale dhe do të mbrohet në heshtje.

I akuzuari L.A në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar: se nuk e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale dhe do të mbrohet në heshtje.

për të pandehurin R.A, meqenëse është vendosur nga gjykata që i njëjti të gjykohet në mungesë, mbrojtësi i tij, ka deklaruar se në fjalën përfundimtare do ti elaboroj arsyet për të cilat konsideron se i mbrojturi i tij është i pafajshëm.

Faktet jokontestuese

Nuk ishte kontestues fakti se ditën kritike fillimisht zyrtaret policor të stacionit Policor në Istog i kanë hasur ketu të pandehurit pa autorizim duke prerë drunj në bjeshkën e Istogut, ne vendin e quajtur Mokne dhe Radushë, pastaj të njëjtit kanë kërkuar përforcime nga stacioni Policor në Pejë, dhe pas arritjes se policeve nga Stacioni Policor në Pejë, ketu të pandehurit janë shoqëruar se bashku me mjetet transportuese dhe masën drusore të prerë, për në oborrin e Kompanisë “Mirëmbajtja” në Istog, dhe pastaj janë arrestuar të pandehurit dhe janë dërguar ne Stacionin Policor në Istog për të dhënë deklarata. I cili fakt është pohuar nga gjitha palët dhe vërtetohet nga provat ne shkresat e lëndës.

Nuk ishte kontestues fakti se ditën kritike në vendin kritik, njëri nga të pandehurit (S.J për të cilin është veçuar procedura penale sepse ka qenë i paarritshëm dhe për te njëjtin është lëshuar urdherarrest), *i njëjti ka filluar qe ti ngacmoj dhe kanos këtu të dëmtuarit – zyrtaret policor, dhe*

ka filluar qe te afrohet afër të dëmtuarit I.L, duke tentuar qe te na godet, pastaj ndaj të njëjtit është përdorur spreji “OC”, i cili fakt është vërtetuar nga provat materiale, raportet e zyrtarëve policor dhe dëgjimi i të dëmtuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Nuk ishte kontestues fakti se ditën kritike, vetëm i dëmtuari Isa Lajqi, ka përdorur sprejin “OC”, vetëm ndaj të pandehurit Sokol Januzaj. I cili fakt u vërtetua nga dëgjimi i të dëmtuarit I.L dhe të dëmtuarve tjerë të cilët kanë deklaruar se nuk kanë përdorur sprej, zyrtaret tjerë policor, ndaj të pandehurve tjerë.

Nuk ka qenë kontestues fakti se në kohën dhe vendin kritik, personat zyrtar të cilët pretendohet në aktakuzë nga prokuroria se janë penguar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, kanë qenë zyrtar policor, ne orare të punës, nga Stacioni Policor në Istog dhe Pejë,.

Faktet kontestuese

Kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti se, cila ka qenë detyra zyrtare te cilën është dashur ta kryejnë zyrtarët policor – këtu të dëmtuarit në kohën dhe vendin kritik, por janë penguar apo ju është pamundësuar që ta kryejnë nga ana e të pandehurve R.A, V.H, S.H dhe L.A Sepse nga prokuroria nuk ka qenë e përcaktuar në përshkrimin faktik të veprës penale në aktakuzë dhe as gjatë seancave gjyqësore.

Kontestues në këtë çështje penale ishte fakti se ditën kritike, në vendin kritik të pandehurit R.A, V.H, S.H dhe L.A secili veç e veç, çfarë force kanë përdorur ndaj këtu të dëmtuarve – zyrtarëve policor qe ti pengojnë në kryerjen e detyrave zyrtare, ngase në përshkrimin faktik të aktakuzës pretendohet se te njëjtit “të revoltuar shkojnë në drejtim të zyrtarve policor duke tentuar që ti godasin me grushta e shqelma”, ndërsa nga gjitha deklaratimet e te dëmtuarve përveç për të akuzuarin S.J për të pandehurit tjerë R.A, V.H, S.H dhe L.A nuk theksohet kanë ndërmarrë veprimet e pretenduara në aktakuzë ne drejtim të dëmtuarve, as se e kanë penguar ndonjërin nga të dëmtuarit ne ndonjë formë dhe as nuk rezulton se ndaj këtyre të pandehurve është përdorur sprej “OC”, ngase te dëmtuarit kanë deklaruar se këta të akuzuar nuk i kanë goditur as nuk kanë tentuar ti godasin me grushta dhe shqelma, siç pretendohet në aktakuzë.

Vlerësimi dhe analizimi i provave

Nga leximi i procesverbalit mbi intervestimin e të akuzuarit L.A i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018, rezulton se i njëjti ka deklaruar se ditën kritike se bashku me të pandehurit tjerë kishin shkuar në bjeshkët e Istogut dhe kishin prerë dhe ngarkuar një sasi te drunjtëve-laneve ne mjetet-traktorët e tyre. Ku në atë lokacion kanë dalur njësitë policor dhe i ka urdhëruar qe mjetet bashkë me sasinë e drunjtëve të dërgonin ne kompaninë “Mirëmbajtja” në Istog.

Nga leximi i procesverbalit mbi intervestimin e të akuzuarit R.A i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018, rezulton se i njëjti ka deklaruar se ditën kritike me datë 30.06.2018 ka shkuar për drunjë për djegieje për të marrë në bjeshkë por pastaj ka ngarkuar edhe lanë-harmoq një traktor ku gjatë ngarkesës janë hasur nga policia dhe në përcjellje të tyre i kanë sjellë drunjtë në “Mirëmbajtje”. Gjatë transportit gjithçka ka shkuar në rregull, mirëpo ne deponi ka

eskaluar situata ku është përdorur edhe sprej nga ana e zyrtareve policor, dhe të pandehurit janë shoqëruar për në stacionin policor.

Nga leximi i procesverbalit mbi intervestimin e të pandehurit S.H i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018, rezulton i njëjti ka deklaruar se si punëtor i të pandehurit R. me datë 30.06.2018 kanë shkuar në bjeshkë dhe kanë prerë një sasi të drurëve dhe pasi i kanë ngarkuar ne traktor dhe janë nisur për në shtëpi janë ndaluar nga policia kufitare dhe pasi të pandehurit nuk kanë pasur dokumentacion me vete, të njëjtit janë shoqëruar për në kompaninë “Mirëmbajtja”, ku i kanë sjellë drutë ne përcjellje te dy veturave të policisë, ku gjatë rrugës një traktor është prishur dhe një është tërheq nga rruga dhe nuk dimë se nga ka shkuar, një polic na pyeti se nga ka shkuar dhe ne nuk ditëm me i tregu dhe na qiti sprej fytirës dhe na kanë sjellë ne stacion policor.

Nga leximi i procesverbalit mbi intervestimin e të akuzuarit V.H i përpiluar në stacionin policor në Istog me datë 01.07.2018, rezulton se i njëjti ka deklaruar se me datë 30.06.2018 rreth orës 11:00, është nisur prej fshatit Uçë për në bjeshkë-Bajshë për tu paisur me dru-lanë, dhe e kam ngarkuar kamionin tim me lanë, në atë momente kanë ardhur policia kufitare dhe patrolla e Istogut, kanë fol me J. dhe me kanë thënë grahi kamionit për Istog, pas pak kanë ardhur edhe 3-4 kerre policë, kam dalur dhe kam folur me ta derisa jemi marrë vesh me shokë dhe jemi nisur për në Istog, policët na kanë shoqëruar deri të rruga e Radushës dhe duke shkuar për të “Mirëmbajtja” një traktor qe ka qenë prapa nesh, ka ik në drejtim të panjohur.

Nga fotografitë e bashkangjitur shkresave të lëndës shihen disa mjete të rënda për transportim ne te cilat shihen te ngarkuar me drunjë te prera.

Nga raportet e oficerve policor J.B D.B, A. G., A.M, I.L V.R, K.A dhe G.A rezulton se te njëjtit kanë raportuar lidhur me veprimet te cilat i kanë ndërmarrë dhe pengesat me te cilat janë përballur në vendin dhe ditën kritike. Në këto raporte perveq se theksohet se njeri nga të dyshuarit (Sokol Januzaj për të cilin është veçuar kjo procedurë penale), ka shkuar ne drejtim te zyrtarve policor duke i sharë dhe ofenduar, duke tentuar që ta godas me boks policin I.L i cili është tërhequr mbrapa dhe ja ka hedhur sprejin OC të dyshuarit që ka sulmuar. Ndërsa në këto raporte nuk theksohet se ndonjëri nga këtu te pandehurit tjerë i ka penguar me forcë zyrtaret policor në kryerjen e detyrave zyrtare.

Elementet e veprës penale

Gjykata ka bërë analizimin e elementeve të veprës penale, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së, ku formën themelore të kësaj vepre penale e kryen: “*Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*”. Ndërsa bashkëkryerja, sipas nenit 31 të KPRK-së, përcaktohet se: “*Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale*”.

Gjykata konstaton se për ekzistimin e kësaj vepre penale të sanksionuar me dispozitën ligjore të sipërcituar, element kryesor është përdorimi i forcës apo kanosjes serioze ndaj personit zyrtar, qe personin zyrtar ta pengoj në kryerjen e detyrave zyrtare. Rrjedhimisht qe një i pandehur apo disa të pandehur me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze, te cilat duhet të dihen se ne çfarë mënyrë është përdorur dhe të jenë te provuara me prova, si dhe personi zyrtar cilën detyrë zyrtare është penguar qe ta kryej, apo duke përdorur mjete të njëjta të pandehurit e detyrojnë personin zyrtar ta kryej detyrën zyrtare. Përkatësisht gjithmonë duhet të specifikohet se cili ka qenë veprimi konkret i personit zyrtar te cilin është dashur ta kryej, si dhe cilat kanë qenë veprimet konkrete të pandehurve, që e kanë penguar personin zyrtar ta kryej detyrën zyrtare apo është detyruar qe ta kryej ndonjë detyrë zyrtare.

Gjykata, gjithashtu rikujton se në nenin 242 të KPP-ës, përcaktohet se si në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore, ndërsa në rastin konkret prokuroria, nuk ka siguruar asnjë provë, përkatësisht me asnjë provë të vetme personale apo materiale, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte nuk ka provuar faktin se të pandehurit **R.A, V.H, S.H dhe L.A** çfarë force fizike apo kanosje serioze kanë përdorur ndaj këtu të dëmtuarve – zyrtarëve policor ditën kritike, qe të njëjtit ti pengojnë ose tentojnë ti pengojnë në kryerjen e detyrave zyrtare! Kjo për faktin se asnjeri nga të dëmtuarit, nuk ka deklaruar në asnjë fazë të kesaj procedurë penale, se këta të pandehur në vendin dhe kohën kritike, ndaj këtu të dëmtuarve kanë përdorur forcë fizike apo kanosje serioze gjatë kryerjes se detyrave zyrtare, as gjatë arrestimit te tyre, si dhe të dëmtuarit kanë deklaruar se, nuk kanë përdorur sprej “OC” ndaj të pandehurve R.A, V.H, S.H dhe L/A.

Mirëpo, këtu të dëmtuarit I.L V.R dhe disa të dëmtuar tjerë, në deklaratimet e tyre në mënyrë të qartë dhe konkrete duke e precizuar edhe me emër, kanë deklaruar se vetëm i pandehuri **S.J** (për të cilin është veçuar kjo procedurë penale sepse nuk ka mundur të sigurohet prezenca e tij në seancat gjyqësore dhe për te cilin ka urdherarrest aktiv), ne kohen dhe vendin kritik, i ka penguar të dëmtuarit në kryerjen e detyrave zyrtare, ku kanë theksuar se i njëjti, ka filluar qe te na ngacmoj dhe kanos, dhe ka filluar qe te afrohet afër nesh/te dëmtuarve (afër te dëmtuarit I.L) duke tentuar qe t’a godet te dëmtuarin I.L pastaj ndaj tij i dëmtuari I.L, ka përdorur sprejin dhe të njëjtin pastaj e ka arrestuar.

Gjithashtu nga prokuroria në aktakuzë, në përshkrimin faktik të veprës penale e cila ju vihet në barrë këtu të pandehurve, fare nuk theksohet se ne vendin dhe kohën kritike cilën detyrë zyrtare/veprim janë penguar qe ta kryejnë këtu të dëmtuarit – zyrtaret policor! Si rrjedhojë edhe pse prokuroria në përshkrimin faktik të veprës penale në aktakuzë, konsideron se këtu të akuzuarit R.A, V.H, S.H dhe L.A “në bashkëkryerje dhe me forcë tentojnë që ti pengojnë **zyrtarët policor** në kryerjen e detyrave zyrtar” ndersa tutje në përshkrimin faktik të aktakuzës, nuk përmendet fare se cilen detyrë zyrtare konkrete janë penguar qe ta kryejnë ketu të dëmtuarit!

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në këtë çështje penale te elaboruara si më lart, mirëpo nga e njëjtat, nuk mund të provohet fakti se ketu të pandehurit R.A, V.H, S.H dhe L.A kanë kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë.

Gjykata ka vlerësuar edhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, mirëpo pretendimi i theksuar nga prokuroria se gjatë shqyrtimit gjyqësor nga provat personale dhe materiale vërtetohet se të pandehurit R.A, V.H, S.H dhe L.A , kanë kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë. Mirëpo te njëjtat pretendime kanë rezultuar të pabazuara ngase me asnjë provë nuk është provuar se të pandehurit R.A, V.H, S.H dhe L.A me forcë kanë tentuar ti pengojnë zyrtaret policor – këtu të dëmtuarit në kryerjen e detyrave zyrtare. Gjithashtu prokuroria as me rastin e ngritjes së aktakuzës e as ne fund të shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare nuk e precizon përshtkrimin faktik të veprës penale, se cila ka qenë detyra zyrtare konkrete të cilën janë penguar zyrtaret policor që ta kryejnë nga të pandehurit në kohën dhe vendin kritik. Gjithashtu pretendimet e prokurorisë kanë qenë edhe kontradiktore ne atë se çfarë është vërtetuar nga dëgjimi i të dëmtuarve, sepse nga dëshmitë e të dëmtuarve ka rezultuar se vetëm i dëmtuari Isa Lajqi ka përdorur sprej, ndërsa prokuroria pretendon se nga dëgjimi i të dëmtuarit V.R, “është vërtetuar se *përdorimi i sprejrit ka qene me qellim qe t’a largoj turmën* e cila ishte duke shkuar ne drejtim te zyrtareve policor”. Ndërsa nga dëshmia e të dëmtuarit I.L ka theksuar se u vërtetua se ditën kritike ne vendin e ngjarjes “ *kur i pandehuri S.J i pari ishte ofruar ne drejtim te tij qe ta sulmoj, mirëpo i njëjti kishte përdorur sprej qe ta zmbrops*”. Shtrohet pyetja se kur te perdoret spreji ne nje situat te till nga ana e një zyrtari policor ne drejtim te nje personi te caktuar, qysh ka deklaruar i demtuari I.L, a nënkupton se është përdorur spreji edhe ne drejtim te personave tjer eventual prezent aty? Normal qe përgjigjja do te ishte jo.

Gjithashtu tutje në fjalën përfundimtare edhe pse prokuroria pretendon se këtu të pandehurit nuk e kishin zbatuar urdhrin e policisë, duke mos theksuar cilin urdhër!, dhe te njëjtit i kanë penguar si grup ne kryerjen e detyrave te tyre. Mirëpo tutje prokuroria thekson se qëndron pran kualifikimit juridik të veprës penale siç akuzohen në aktakuzë, ndërsa edhe pse thekson se “kanë vepruar si grup”, nuk bën ricilsimin juridik të veprës penale qe eventualisht veprës penale e cila ju vihet të barrë të pandehurve, të i’a shtoj edhe paragrafin 2, ku përcaktohet kur vepra te tilla penale “kryhet nga grupi i personave qe me veprime të përbashkta pengojnë ose tentojnë të pengojnë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen dhe fjalën përfundimtare të akuzuarve V.H, S.H dhe L.A të cilët kanë deklaruar se nuk e ndjejnë vetën fajtor për këtë vepër penale dhe me asnjë veprim ditën kritike nuk e kanë penguar asnjë zyrtar policor. Gjithashtu ka vlerësuar edhe fjalën përfundimtare të mbrojtësit të pandehurit R.A, av. Fadil Jashari, i cili ka theksuar se i mbrojturi i tij nga administrimi i provave në këtë çështje penale, shihet qartë se nuk është i përfshirë ne pengimin e personave zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare.

Gjykata pasi analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat materiale dhe personale te administruara në këtë çështje penale, vërtetoi se prokuroria nuk ka arritur të argumentojë faktin se të akuzuarit R.A, V.H, S.H dhe L.A ditën kritike me forcë apo kanosje serioze kanë penguar personat zyrtar, këtu të dëmtuarit zyrtaret policor në kryerjen e detyrave zyrtare.

Meqenëse në këtë çështje penale me asnjë provë nuk u vërtetua elementi kyç i veprës penale, se këtu të pandehurit R.A, V.H, S.H dhe L.A kanë përdorur forcë apo kanosje serioze qe ti pengojnë këtu të dëmtuarit zyrtaret policor në kryerjen e detyrave zyrtare, gjykata erdhi në përfundim se

nuk janë përmbushur as elementet e veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata rikujton se, është shqetësues fakti se, prokuroria ngrit aktakuza të tilla të drejtpërdrejta pa zhvilluar hetimet, ne përshkrimin faktik nuk thekson se ne vendin dhe kohën kritike cila ka qenë detyra zyrtare apo urdheri i zyrtarëve policor, ne drejtim të akuzuarve i cili nga të akuzuarit është penguar apo tentuar të pengohet që të zbatohet. Me asnjë provë materiale nga të dëmtuarit – raportet e zyrtarëve policor këtu të dëmtuarve nuk ishin të theksuara veprimet inkriminuese konkrete të pandehurve R.A, V.H, S.H dhe L.Aku as nuk ka qenë i provuar dyshimi i bazuar mire se këta të pandehur kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, mirëpo ne këto raporte kanë qenë të specifikuara vetëm veprimet inkriminuese të pandehurit Sokol Januzaj! Gjithashtu në arsyetimin e kësaj aktakuzës prokuroria thekson se **“në këtë çështje penale nuk janë zhvilluar hetimet pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit në bashkruerje kanë kryer veprën penale për të cilën pandehen”**, me një konstatim të tillë, prokuroria në mënyrë të hapur i anashkalon fillimin e hetimeve në këtë çështje penale dhe cenon vërtetimin e saktë dhe të plotë të gjendjes faktike. Sepse që nga fillimi i kësaj procedure penale, prokuroria ka qenë në dijeni se personat zyrtar – kanë qenë “zyrtaret policor” jo një por tetë zyrtar policor, ndërsa dispozita ligjore e nenit 409 par.5 të KPRK-së, ka përcaktuar mënyrën kualifikuese të kësaj vepre penale, përkatësisht kur vepra të tilla penale ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë kryer ndaj **“zyrtarit policor”**, me automatizëm në cilësimin juridik të veprës penale duhet të përfshihet edhe paragrafi 5 i nenit 409 të KPRK-së, e jo vetëm paragrafi 1, i këtij neni qysh ka vepruar prokuroria gjatë gjithë procedurës!, rrjedhimisht pastaj zhvillimi i hetimeve nga ana e prokurorisë sipas Kodit të Procedurës Penale është i obligueshëm, sepse sanksioni penale i kësaj vepre penale kur përfshihet në cilësim juridik të kësaj vepre penale përveç par.1 edhe paragrafin 5, sanksioni penal është një (1) deri pesë (5) vjet burgim. Ndërsa, gjykata edhe pse e ka vërejtur këtë cilësim jo adekuat të veprës penale, te njëjtin në asnjë rast nuk ka mundur t’ a ricilësoi sipas detyrës zyrtare, sepse nuk është e lejuar me dispozitat e KPP-së, të bëhet asnjë ricilesim i veprave penale sipas detyrës zyrtare, kur i njëjti rikualifikim do të shkonte në disfavor të pandehurve në një çështje konkrete.

Gjykata, rikujton gjithashtu një nga parimet kryesor të procedurës penale ”In dubio pro reo”, përcaktuar në nenin 3 të KPP-së, i cili përcakton se: *“mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij”*.

Prandaj, Gjykata në rastin konkret, duke pasur parasysh nenin 7 par.1 dhe 2 të KPP-së, ku përcaktohet se gjykata, prokuroria dhe policia, janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe detyrohen që me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të akuzuarit dhe në favor të tij, si dhe nenit 6 te KEDNJ-së, nenit 14 te PNDKP-së dhe nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, instrumente këto nacionale dhe ndërkombëtare, te cilat na obligojnë në zbatimin e gjykimit të drejtë, bazuar në nenin 3 par.2 të KPP-së, ku është përcaktuar se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të akuzuarit, andaj bazuar në këto dispozita ligjore dhe vlerësimet

të gjitha provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit R.A, V.H, S.H dhe L.A kanë kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj konform nenit 363 par.1 nën par. 1.3 të KPP-së, i liroi të akuzuarit nga akuza si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së. Ndërsa meqenëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 19.04.2024, prokuroria ka theksuar se J.B, I.Sh dhe B.K nuk do të jenë me palë të dëmtuara në këtë çështje penale ngase kanë deklaruar se nuk e ndjejnë vetën të dëmtuar në këtë çështje penale. Prandaj gjykata te njëjtit nuk i udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës eventuale pasurore juridike.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura dhe në pajtim me nenin 360, 361 dhe 363 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

Sekretarja juridike
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.